



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 03-03/DPK	Nr Prot. Bi Prot. Prot No. 01-1883/16
Nr.faq. Broj. stranice Nr. pages 03	Data Datum Date 27-05-2016
SHQIPTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	27/05/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1789/16
PËR/ZA/TO:	z. Besim TAHIRI U.d. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës
CC:	z. Xhelil BEKTESHI Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, segmenti: Suharekë- Korishë, L=1,270.2m"

I nderuar z. Tahiri,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: "Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, segmenti: Suharekë- Korishë, L=1,270.2m" me numër prokurimi: MI 16 041 511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: "Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, segmenti: Suharekë- Korishë, L=1,270.2m" me numër prokurimi: MI 16 041 511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për

Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Ministria e Infrastrukturës ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, segmenti: Suharekë- Korishë, L=1,270.2m" me numër prokurimi: MI 16 041 511, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 20/04/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues-MI ka paraparë procedurë të hapur për punë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues- MI ka formuluar kërkesa minimale të kualifikimit të cilat janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Në Dosjen e Tenderit "Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, segmenti: Suharekë- Korishë, L=1,270.2m" tek pika 2 Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: Udhëheqësi i Punishtes të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me 2 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruimit të rrugëve. Të ketë dëshmi se ka realizuar së paku dy (2) projekte në lëmin e kërkuar. Vlera e projekteve të udhëhequra të jetë minimum **500,000.00€**.

Sipas neni 23 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Autoriteti Kontraktues ka të drejt që në kuadër të kërkesave mbi Afësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkoj kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxherial dhe CV-të e tyre, por jo edhe të bëjë kufizime të tilla mbi vlerën e projekteve të udhëhequra.

Po ashtu tek pika 6 e po të njëjtave kërkesa Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: Listë e kontratave jo më pak se **2,500,000.00€**, të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare (2013, 2014 dhe 2015).

Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj që Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik të kete realizuar punët e natyrë së ngjashme, edhe atë mund ta kërkoj për periudhën e tre viteve të fundit duke i vendosur edhe një vlerë të caktuar të projekteve, por vlera e tillë nuk mund të tejkaloj **1.5 herë** vlerën e parashikuar të kontratës.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 69 Afësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenin 23 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.



Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

